[ Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

#### 1. Zgjatues elektrik ballandez

Një zgjatues elektrik balandez është një objekt i rumbullakët, në formë barabani, siç është një bobinë që përdoret për të mbajtur lloje të ndryshme të telave elektrikë. Rrotullat e kablllove, të cilat gjithashtu mund të quhen balandez, janë përdorur për shumë vite për të transportuar kablllo elektrike, kablllo me fibër optike dhe produkte teli. Rrotulla e kablllove të jetë plastikë e fortë dhe cilësore për një rezistencë dhe jetëgjatësi të mirë.

#### Të dhënat teknike minimale:

- Numri i moduleve: 4 priza shuko
- Gjatësia minimale: 25-30m.
- Modeli: Me siguresë termike + kapak për prizat
- Seksioni (mm<sup>2</sup>): 3x2.5
- Ngjyra: N/A
- Materiali: Plastik+Bakër
- Pesha: ≤ 10kg

#### 2. Çekiç mekaniku

Çekiçi të jetë me dorezë me fibër qelqi, që përdoret për goditjen e daldave, gozhdëve dhe punime të ndryshme. Ky çekiç duhet të jetë i trajtuar termikisht dhe të jetë shumë i rehatshëm në përdorim nga specialisti. Të ketë një fortësi të çelikut sipas standartit C45CE ose ekuivalenti i tij.

- Pesha: 900g-1000g
- Dorezë: dorezë fiber qelqi
- Materiali: Çelik

---

### 3. Çelës anglez i madh

Çelësi anglez 15"(375mm), të ketë nyje të madhe për rregullim më të lehtë dhe më të ngushtë të nofullës. Me dorezë të gjerë për të përmirësuar komoditetin dhe për të zvogëluar lodhjen. Me material çeliku të trajtuar termikisht për rezistencë dhe qëndrueshmëri të lartë. Të sigurojë një hapje të madhe të nofullës, me shkallë treguesi të gdhendur me lazer. Të jetë rezistent ndaj ndryshkut dhe korrozionit. Të pastrohet lehtë pas përdorimit.

- Përmasat: 15"(375mm)
- Hapja e nofullës: 0-43mm

### 4. Set çelësa tub Ø8 - Ø22mm

Çelësi tub me dy përmasa në një çelës, në sajë të formës së tij bën të mundur përdorimin në vende të ngushta, ku nuk mund të përdoren çelësat e tjerë, si dhe për pajisje ku dadot apo bulonat e kanë kokën e shkurtër. Minimumi të ketë në përbërje çelësa të pëmasave 8-9mm, 10-11mm, 12-13mm, 14-15mm, 16-17mm, 18-19mm, 20-22mm.

### 5. Daltë matrapiku me majë me shlica

Daltë profesionale 400mm, me majë. Përdoret për thyerjen e betonit dhe sipërfaqeve të tjera të forta. E ndërtuar me çelik special, siguron fortësi dhe qëndrueshmëri.

- Materiali: Çelik
- Kapja: SDS-plus

### 6. Daltë matrapiku petashuq me shlica

Daltë profesionale 400mm, pllakë. Përdoret për thyerjen e betonit dhe sipërfaqeve të tjera të forta. E ndërtuar me çelik special, siguron fortësi dhe qëndrueshmëri.

- Materiali: Çelik
- Kapja: SDS-plus

### 7. Daltë me majë

Dalta me përmasë Ø18mm ± 1mm x 300 ± 10 mm. Përdoret për thyerjen e betonit dhe sipërfaqeve të tjera të forta. Doreza të jetë e veshur me gominë dhe me mbrojtëse për dorën. Dalta të përbëhet nga material krom-vanadium me teh çeliku. Ato të jenë të përbëra nga bosht metalik për përdorim me çekiç. Të ketë një fortësi të çelikut sipas standartit C45CE ose ekuivalenti i tij.

- Gjatësia: 300mm ± 10 mm
- Diametri i boshtit metalik: Ø 18mm
- Materiali: Krom-Vanadium
- Mund te mprihet: Po

### 8. Daltë petashuqe

Dalta me përmasë Ø18mm ± 1mm x 300mm ± 10 mm dhe tehu me gjerësi 24mm ± 1mm. Përdoret për përpunimin në sipërfaqe të forta betoni, doreza të jetë e veshur me gominë dhe me mbrojtëse për dorën. Dalta të përbëhet nga material krom-vanadium me teh çeliku. Ato të jenë të përbëra nga bosht metalik për përdorim me çekiç. Te kete nje fortësi të çelikut sipas standartit C45CE ose ekuivalenti i tij.

- Gjatësia: 300mm ± 10 mm
- Diametri i boshtit metalik: Ø18mm
- Materiali: Krom-Vanadium
- Mund te mprihet: Po

---

### **9. Elmaz xhami (profesional)**

Prerës xhamash elmaz për përdorim profesional, metalik. Prodhuar nga materiale të temperuara dhe me finitura perfekte për të arritur rezultatet e dëshiruara. Jetëgjatësia e prerjes jo më pak se 5000m. Materiali: Çelik me gjatësi 170mm-190mm.

### **10. Fletë (lamë) sharre për sega**

Fleta e sharrës me gjatësi 110mm- 120 mm të jetë me dhëmbë të përshtatshëm për dru dhe laminat, të përbëhet nga një material çeliku i trajtuar në të nxehtë. Këto fletë të jenë të përshtashme për zëvendësimin e fletëve të sharrës që dëmtohen ose konsumohen.

- Materiali: Çelik
- Përmasa: 110mm – 120mm
- Trashësia e prerjes: jo më pak se 50mm

### **11. Govatë llaçi**

Një produkt të jetë i prodhuar nga një material plastik i lehtë dhe i fortë në të njëjtën kohë. Përdoret kryesisht në fushën e ndërtimit për përgatitjen dhe transportimin e materialeve si llaçi, kolla apo produkte të tjera inerte. Të ketë volum 25lt-30lt. Gjatësia > 60cm, Gjerësia > 40cm, Thellësia > 17cm.

### **12. Indikator rryme elektrike profesional**

Indikator rryme elektrike për prezencë tensioni deri në AC 100-500V.

- Tipi: Indikator tensioni
- Rryma: 10A
- Gjatësia: 200mm ± 20 mm

### **13. Pistoletë gazi (torçë) për katrama**

Pistoletë gazi (torçë) profesionale për katrama. Materiali duhet të jetë i përshtatshëm për të duruar temperaturat e larta, të jetë funksionale për hidroizolimet. Diametri i djegësit të jetë Ø60mm±5mm. Gjatësia e pistoletës 100cm±10cm. Presioni gjatë punimit 4-12 bar. Teperatura maksimale e djegjes jo më pak se 1800 °C. Pesha jo më shumë se 1200g. Materiali i djegësit të jetë i përbërë prej çeliku të zinkuar ose të pandryshkshëm. Materiali i tubit metalik zgjatues nga djegësi deri tek doreza të jetë i përbërë prej bronzi ose çeliku të zinkuar/të pandryshkshëm.

### **14. Mallo metalike me dhëmbë**

Të jetë e përpunuar nga çelik i pandryshkshëm dhe rezistente ndaj deformimit. Të jetë me dorezë plastike. Përmasat: Gjatësia: 280mm±20mm Gjerësia; 120±10mm, me dhëmbë 10x10mm.

### **15. Mallë plastike**

Mallë Patinimi, me përmasa 400mm±20mm x 250mm±20mm. Të jenë të prodhuara nga materiali plastik i fortë. Përdoret nga muratorët për punime të ndryshme me llaç, allçi, etj.

### **16. Mallë metalike**

Mallë metalike me përmasa 280mm±20mm Gjerësia; 120±10mm janë të prodhuara nga çelik i pandryshkshëm, që ruan formën e mëparshme pavarësisht deformimit dhe me dorezë druri plastike.

---

### **17. Mastar alumini**

Mastar alumini me gjatësi 2.5m-3m, rezistent ndaj goditjeve, përdoret nga muratorët për nivelimin e suvatimeve. Të jetë me dorezë ergonomike që siguron një mbrojtje nga të ftohtit dhe kundra rrëshqitjes nga dora. Përmasat: Gjatësia 250mm-300mm, Gjerësia 80mm±5mm, 35mm±5mm, Trashësia (spesori) 1.5mm±0.2mm

### **18. Metër**

Metër çeliku me gjatësi  $\geq 5$ m. Ky metër të jetë një produkt i prodhuar me një finiturë perfekte ku ndërthurja e elementëve të plastikës e bën elegant dhe të qëndrueshëm. Të durojë goditjet, përplasjet dhe të ketë një ndarje të saktë metrike për të bërë një matje perfekte. Gjithashtu të ketë një mekanizëm për hapjen dhe mbyllje automatike dhe të ketë mekanizëm fiksues të shiritit metrik sipas nevojës së përdoruesit. Shiriti metalik të jetë i përbërë prej çeliku special me gjerësi jo më pak se 25mm.

### **19. Metër shirit**

Metër shirit me gjatësi  $\geq 30$ m i cili përdoret gjerësisht në fushën e ndërtimit nga muratorët, arkitektët, inxhinierët etj. Leximi i këtij metri të bëhet mjaft lehtë dhe të jetë në sistemin metrik dhe në inch. Shiriti të jetë i përbërë prej fibre qelqi dhe shumë rezistent. Gjerësia e shiritit jo më pak se 12mm. Të ketë mekanizëm për mbledhjen e shiritit manual ose automatik.

### **20. Mistri**

Mistria të jetë e prodhuar nga çeliku special, i cili ruan formën e mëparshme pavarësisht deformimit dhe e pajisur me dorezë plastike. Diametri i boshtit metalik ku montohet doreza të jetë çelik special jo më pak se  $\varnothing 8$ mm. Të jetë e përshtatshme për të gjitha llojet e punimeve të ndërtimit, kryesisht suvatim. Gjatësia: 170mm-200mm.

### **21. Nivelues alumini me magnet**

Niveluesi me magnet të jetë me gjatësi 100-120cm, dhe të përmbajë jo më pak se 3 tregues niveli akrilik të cilët janë rezistent ndaj goditjeve, dhe të sigurojnë një lexim të mirë duke mundësuar një pamje të treguesve nga sipër dhe duke eliminuar lodhjen e qafës dhe shpinës. Të jetë e pajisur me dorezë ergonomike që siguron një mbrojtje nga të ftohtit dhe kundra rrëshqitjes nga dora.

### **22. Përdaf muratori**

Përdaf muratori të jetë me gominë, me dorezë plastike dhe me bazë alumini ose çeliku special. Kz produkt përdoret për finiturën e suvatimeve, patinimeve etj. Përmasat: Gjatësia: 250mm±20mm, Gjerësia: 120mm±20mm, Trashësia e gominës: 17mm±3mm.

### **23. Preçinator profesional**

Preçinator domosdoshmërisht për përdorim profesional, trupi të jetë prej çeliku ose alumini special dhe të jetë të prodhuar nga material i përpunuar termikisht për të bërë të mundur kapjen dhe fiksimin e perçinave në katër përmasa të ndryshme: 2.4 mm deri në 4.8 mm.

### **24. Prerës tubash plastik**

Kjo prerëse tubi përdoret për prerjen e tubave të PVC (Markush), Tuba LDPE etj. Mund të presë tubat deri në 42mm. Përmasat: Gjatësia: 220mm-250mm, Gjerësia: 90mm-100mm, Gjatësia e lamës: 50mm -55mm, Hapja e nofullës: jo më pak se 42mm. Materiali: Çelik special.

---

### **25. Zorrë uji plastike me diametër 1/2".**

Të jetë e ndërtuar nga minimumi 3 shtresa ç'ka e bën atë shumë të qëndrueshme, rezistente ndaj temperaturave dhe rezistente ndaj rrezeve UV. Të jetë e projektuar për t'i bërë ballë presionit deri në 10,bar. Të jetë lehtësisht e montueshme në të gjitha llojet e rakorderive apo ujitësve të ndryshëm. Zorra të jetë rezistente ndaj ngërçit me një përforsim të veçantë të thurur që garanton qëndrueshmëri të shkëlqyeshme në presion të lartë të ujit, të jetë rezistente ndaj algave dhe rezistente ndaj ultravioletit dhe mos të përmbajnë metale të rënda ose ftalate. Gjatësia minimale e pandërprerë e zorrës me diametër 1/2" të jetë 50m dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

### **26. Mbështjellës për zorrë uji plastike 1/2" dhe 5/8".**

Mbështjellësja e zorrës së ujit të jetë me kornizë alumini dhe me pjesët e tjera prej pastike të fortë, duke e bërë atë veçanërisht të lehtë dhe rezistente ndaj shiut dhe lagështisë. Të jetë e pajisur me një dorezë anatomike të rehatshme. Seksionet kryq të rotorit të jenë krijuar pa skaje të mprehta dhe të kenë një strukturë të fortë. Rotori të jetë plastik i pajisur me kushineta najloni, duke e lejuar atë të rrotullohet pa probleme për të mbështjellë zorrën e ujit. Të ketë minimumi 2 (dy) rrota të konturuara mbi të cilat mbështetet gjithë pesha e pajisjes gjatë lëvizjes nga një vend në tjetrin. Të ketë paketim kompakt për të lehtësuar transportin, magazinimin dhe të montohet shpejt pa ndihmën e mjeteve speciale. Gjatësia minimale e zorrës me diametër 1/2" që mund të mbështillet nga pajisja të jetë 50m. Pajisja të mos jetë më e rëndë se 3 (tre) kilogramë.

### **27. Mbështjellës për zorrë uji plastike pajisur me rakorderi.**

Mbështjellësja e zorrës së ujit të jetë me kornizë alumini dhe me pjesët e tjera prej pastike të fortë dhe kompakte që mund të varet në mur ose të transportohet kudo që është e nevojshme, pa ndonjë problem hapësinor. Të jetë e pajisur me një dorezë anatomike të rehatshme. Seksionet kryq të rotorit të jenë krijuar pa skaje të mprehta dhe të kenë një strukturë të fortë. Rotori të jetë plastik i pajisur me kushineta najloni, duke e lejuar atë të rrotullohet pa probleme për të mbështjellë zorrën e ujit. Të jetë me përmasa të reduktuara, e lehtë për tu transportuar, dhe të montohet shpejt pa mjete speciale dhe të jetë e kompletuar me minimumi 15 metra zorrë 1/2", e pajisur me grykë spërkatëse për të gjitha nevojat për transmetim të ujit nga një vend në tjetrin. Të ketë lidhës rubineti 3/4 " me zvogëlues 1/2", 4 bashkime automatike ku një të jetë me aquastop për të lidhur dhe shkëputur grykën e rakorderisë pa pasur nevojë të mbyllet rubineti. Pajisja së bashku me zorrën e ujit të montuar të mos jetë më shumë se 4 kilogramë.

### **28. Metër për matje largësie me lazer.**

Të jetë lehtësisht i përdorshëm dhe me projektim kompakt. Të jetë me përdorim të gjerë në fushat e arkitekturës dhe inxhinierisë. Të kryejë matje perfekte të largësive jo më pak se 60m, me gabim të pa konsiderueshëm jo më shumë se  $\pm 2$  mm. Të jetë i ndërtuar nga materiale të cilësisë së parë dhe të jetë i veshur me gomë të butë, për të rezistuar ndaj impaktit të goditjeve gjatë punës. Ekranit të jetë lehtësisht i lexueshëm. Të ketë aftësi logaritime të shumës se distancave të matura, të sipërfaqes dhe vëllimit të hapësirës së punës. Të jetë i klasifikuar si produkt profesional.



---

### **29. Set puntosh betoni.**

Punto betoni set Ø 4-10mm. Puntot të ofrojnë një jetëgjatësi operacionale dhe shpim më të shpejtë në beton. Të jenë shumë rezistentë në përkulje dhe mund të përdoren në shpim dhe goditje. Të jenë të përshtatshëm për trapanët me goditje dhe për trapanët me mandrino me shtrëngim. Të jenë të përshtatshëm për shpime në beton, gur dhe pllakë. Seti duhet të përbëhet minimalisht nga 5 punto, me Ø 4, 5, 6, 8, 10mm. Materiali: Çelik i përforcuar.

### **30. Set puntosh druri.**

Punto druri profesionale Ø 3-8mm. Përdoren për të shpuar në të gjitha llojet e drurit dhe materialet e ngjashme me to. Të jetë e ndërtuar me çelik special që siguron një shpim të shpejtë dhe preçiz. Punto të jetë me cilësi dhe jetëgjatësi të lartë. Seti duhet të përbëhet minimalisht nga 5 punto me Ø 3, 4, 5, 6, 8mm. Materiali: çelik i përforcuar.

### **31. Set bazik punto metali HSS.**

Punto metali HSS (*high speed steel*) të një cilësie të lartë. Përdoren për të shpuar në të gjitha llojet e metalit dhe materialet e ngjashme me të. Të jetë e ndërtuar me çelik special që siguron një shpim të shpejtë dhe preçiz. Punto të jetë me cilësi dhe jetëgjatësi të lartë. Seti duhet të përbëhet minimalisht nga 4 punto me Ø 5, 6, 6.5, 7 mm. Materiali: çelik i përforcuar.

### **32. Set puntosh betoni SDS-PLUS.**

Punto betoni SDS-PLUS (kapje me shlica) set Ø 6-12mm. Puntot të ofrojnë një jetëgjatësi operacionale dhe shpim më të shpejtë në beton. Të jenë shumë rezistentë në përkulje dhe mund të përdoren në shpim dhe goditje. Të jenë të përshtatshëm për trapanët me goditje dhe me mandrino SDS-PLUS. Të jenë të përshtatshëm për shpime në beton, gur dhe pllakë. Seti duhet të përbëhet minimalisht nga 5 punto, me Ø 6x110, 8x110, 8x160, 10x160, 12x160mm. Materiali: Çelik i përforcuar.

### **33. Sharrë dore druri.**

Sharrë dore druri 16''-18'' (40-50cm), përdoret nga zdrukthtarët, marangozët etj. Të jetë me dhëmbë të përforcuar për rritje të kohës së përdorimit dhe me dorezë plastike për të maksimizuar komfortin gjatë përdorimit. Të jetë e përshtatshme për prerje të drejta apo harkore të drurit, dërrasave etj. Materiali: Çelik special.

### **34. Sharrë dore hekuri me lama të ndërrueshme.**

Sharrë dore hekuri, profesionale për lama 12" (300 mm), me konstrukt solid me dorezë plastike për kapje të mirë dhe komforte. Forma katrore në fundin e konstruktit mundëson vendosjen e lamës në katër pozicione të ndryshme. Te jete e mundshme për tu përdorur për prerje vertikale dhe horizontale. Sharra duhet të jete rezistente ndaj ndryshkjes. Gjatësia: 450-550mm, Gjatësia e lamës: 300mm standarte, Materiali: Çelik.

### **35. Lama për sharrë dore hekuri.**

Fleta (lama) e sharrës të jetë me gjatësi 300mm standarte dhe në të dyja skajet të ketë vrima për montimin në sharrën e hekurit. Të jetë prodhuar nga një material çeliku/ karbon me teh ideal dhe fleksibël për prerje çeliku të butë, bronzi, alumini, bakri dhe materiale të ngjashme. Këto fletë të

---

jenë të përshtashme për zëvendësimin e fletëve të sharrës që dëmtohen ose konsumohen. Materiali: Çelik, Gjatësia: 300mm, Gjerësia: 12±2mm.

### **36. Sqepar.**

Sqepari të jetë me dorezë druri ose fibër qelqi, me peshë 400-450gr pa bishtin dhe të përdoret lehtësisht nga ndërtuesit, muratorët, karpentierët etj, për punime të ndryshme. Të ketë fortësi prej HRC 55-58 ose ekuivalente. Materiali: Çelik i farkëtuar. Gjatësia e bishtit: 40-45cm.

### **37. Kazmë pa bisht.**

Kazma të jetë me peshë 2-2.5 kg dhe të jetë e përshtashme për gërmime në terrene të forta dhe të buta si edhe për prerjen e rrënjëve apo drunjëve gjatë punës. Materiali të jetë çelik i farkëtuar, i cili i jep kazmës një qëndrueshmëri dhe rezistencë të madhe gjatë punës. Syri i kazmës ku montohet bishti të jetë në formë ovale dhe i përshtatshëm për t'u montuar një bisht oval në skajin e kapjes me diametër 55mm me 40mm.

### **38. Bisht për kazma.**

Bisht druri me përmasa 90-95cm, dhe të jetë i përshtatshëm për kazma. Bishti siguron qëndrueshmëri të lartë në punët tuaja, në sajë të formës dhe peshës së tij ideale. Të jetë i punuar me kujdes dhe me një finiturë për mos dëmtuar duart gjatë punës me dimetër Ø 40mm ±2mm në boshtin e tij dhe oval në skajin e kapjes me diametër 55mm me 40mm.

### **39. Karrocë dore.**

Karrocë dore me pjesën mbajtëse të galvanizuar, ndërtimi për përdorim të ndryshëm dhe përdorime në industri. Karroca e dorës e galvanizuar të ketë një kapacitet me volum prej 90-100 Lt dhe të jetë e pajisur me një rrotë pneumatike e cila është e përshtatshme për sipërfaqe të forta apo të buta dhe doreza gome për më shumë komoditet. Materiali: strukturë me tuba çeliku, lyerje me pjekje, pjesa mbajtëse e ndërtuar prej çeliku të galvanizuar për rezistencë ndaj kushteve atmosferike dhe për më shumë qëndrueshmëri. Trashësia e llamarinës së galvanizuar të jetë jo më pak se 0.8mm. Diametri i jashtëm i tubave të skeletit mbajtës të jetë 30-32mm me trashësi (spesori i tubit) 1.5-1.8mm dhe të jetë të ljera në mënyrë elektrostatische për një qëndrueshmëri sa më të gjatë të bojës. Rrota pneumatike të jetë e tipit european Ø,350mm me disk metalik dhe trashësi të gomës 70mm ose ekuivalente.

### **40. Rrota për karrocë dore.**

Rrota gome pneumatike për karrocë dore. Rrota të jetë prej gome pneumatike të jetë e tipit european Ø,350mm me trashësi gome 70 mm me disk metalik ose ekuivalente.

### **41. Lopatë pa bisht.**

Lopatë me bazë ovale e cila të jetë e përshtashme për transferimin e materialeve inerte, si dhe për pastrimin apo grumbullimin e materialeve të tjera. Materiali të jetë prej çeliku i temperuar që siguron fortësi dhe qëndrueshmëri. Përmasat: Gjatësia pa bishtin 250-280mm, gjerësia pa bishtin 230-270mm, pesha 1-1.2kg.

---

#### **42. Bisht lopate**

Bishti i drurit të jetë i përshtatshëm për lopata çeliku. Të jetë i prodhuar nga një material druri mjaft rezistent dhe i punuar me makineri për t'i dhënë një formë dhe rehati në përdorim. Përmasat: Gjatësia: 1200-1400 mm, diametri i boshtit 40mm ±2mm.

#### **43.Thika me lamë**

Thika me tehe të ndërrueshme vjen në dorën tuaj nga një material shumë cilësor dhe përdoret në fusha të ndryshme të ndërtimit apo restaurimeve në shtëpitë apo vendet tuaja të punës. Me një dorezë mjaft të rehatshme duke ju lehtësuar përdorimin e saj pa ju lodhur dhe për lama me gjerësi të tehut 18-20mm dhe gjatësi 80-100mm.

#### **44. Set lame**

Set me lama thike me gjerësi 18-20 mm dhe gjatësi 80-100mm ku seti të ketë jo më pak se 10 copë. Me tehe të trajtuara termikisht me trashësi 0.5 mm. Materiali: çelik special.

#### **45. Sharrë dore për gips**

Kjo sharrë të jetë me një veprim të shumëfishtë dhe e përshtatshme për prerjen e gipsit në çdo pozicion. Materiali të jetë çelik dhe të përdoret kryesisht nga specialistet në fushën e ndërtimit me mure të thata (mure gipsi), për dhënien e formave apo hapjen e vrimave për instalimin e pajisjeve të ndryshme. Të jetë me tehe të trajtuara termikisht për njërezultat sa më efikas gjatë punës. Tehu prej çeliku të ketë një gjatësi 150-180mm.

#### **46. Set çelësash hegzagon.**

Ky set çelësash hegzagonal i përbërë nga minimumi 8 copë Ø 2, 2,5, 3, 4, 5, 6, 8, 10mm dhe të jenë të përshtatshme për tu përdorur për lirimin apo shtrëngimin e vidave me kokë hegzagonale femër. Materiali të jetë krom vanadium.

#### **47. Set kaçavidash profesionale.**

Seti profesional i kaçavidave përdoret gjerësisht në fushën e mekanikës dhe mirëmbajtjes. Seti të përbëhet minimumi nga 6 copë me përmasa si vijon: 2 copë (kryq dhe e sheshtë) të jenë me gjatësi totale 150mm ±10mm dhe diametër të boshtit metalik 6mm±1mm, 2 copë (kryq dhe e sheshtë) të jenë me gjatësi totale 100mm ±10mm dhe diametër të boshtit metalik 5mm±1mm dhe 2 copë (kryq dhe e sheshtë) të jenë me gjatësi totale 70mm ±10mm dhe diametër të boshtit metalik 5mm±1mm. Materiali: Krom-Vanadium kurse bishti të jetë plastik i veshur me gominë për një stabilitet gjatë punimit.

#### **48. Pinca universale.**

Pincat të jenë me gjatësi 180mm-200mm dhe të prodhuara nga një material Chrom-Vanadium për një përdorim të gjatë. Tehet prerës të jenë të trajtuara termikisht dhe këndi prerës të jetë i optimizuar për të pasur një fuqi prerje perfekte dhe preçize. Doreza të jetë e përbërë nga një përzierje materiali special plastik për të qenë të përshtatshme dhe rezistente gjatë punës.

#### **49. Pinca profesionale VDE.**

Pinca profesionale VDE me gjatësi 160mm-180mm. Pinca të jetë e izoluar për një tension deri në 1000V dhe të jetë prodhuar nga një material shumë rezistent të trajtuar termikisht si dhe të ketë një formë mjaft të përshtatshme për të punuar në hapësira të ngushta, të jetë për përdorim nga

---

profesionistët në punimet elektrike, në sajë të dorezës të rehatshme dhe izoluese nga prania e tensionit. Të plotësojë Standartin Shqiptar SSH EN 60900:2012 ose ekuivalentin e tij. Materiali i pjesës metalike: Krom-Vanadium.

#### **50. Tronkëza (pinca prerëse diagonale)**

Pinca prerëse diagonale me madhësi 160mm-180mm. Pinca të jetë një produkt mjaft rezistent dhe komfort në përdorim për të bërë prerje, të materialeve të ndryshme. Të jetë me tehe të forta të trajtuara termikisht dhe material shumë rezistent.

- Materiali: krom-Vanadium
- Përmasa: 160mm-180mm

#### **51. Havi kallaji profesionale**

Havi kallaji përdoret për aplikime të ndryshme në fushën e riparimeve elektronike.

- Fuqia:  $\geq 100w$
- Tensioni: 220v - 240v, 50/60Hz
- Gjatësia e kabullit: 1m - 1.5m

#### **52. Kabëll starteri me kapëse (kavo baterie)**

Kabëll starteri jo më pak se 600A e cila shërben për ndezjen e automjeteve/mjeteve teknike me anë të një burimi alternativ fuqie në rastin kur bateria është e shkarkuar. Fijet e kabullit të përbëhen prej 100% bakër të veshura me plastikë të cilat realizojnë një trasmetim të shkëlqyer të rrymës. Kjo kavo të jetë me gjatësi jo më pak se 3m dhe në skajet e saj të jenë të kapura pinceta prej bakri 100% të veshura me plastikë.

- Amperazhi:  $\geq 600$  AMP
- Gjatësia e kabullit:  $\geq 3m$
- Trashësia e kabullit 9mm-12mm

#### **53. Kaçavidë mekanike me majë kryq**

Kjo lloj kaçavide përdoret gjerësisht në fushën e mekanikës dhe mirëmbajtjes. Kaçavida të jetë me gjatësi totale 150mm -180mm dhe diametër të boshtit metalik  $6mm\pm 1mm$ , Materiali: Krom-Vanadium kurse bishti të jetë plastik i veshur me gominë për një stabilitet gjatë punimit.

#### **54. Kaçavidë mekanike me majë petë**

Kjo lloj kaçavide përdoret gjerësisht në fushën e mekanikës dhe mirëmbajtjes. Kaçavida të jetë me gjatësi totale 150mm -180mm dhe diametër të boshtit metalik  $6mm\pm 1mm$ , Materiali: Krom-Vanadium kurse bishti të jetë plastik i veshur me gominë për një stabilitet gjatë punimit.

#### **55. Set çelësa hidraulik papagall**

Çelës hidraulik papagall për punime hidraulike etj. Seti të përbëhet minimumi nga 4 (katër) copë me përmasa si vijon: 10'' (250mm), 12'' (300mm), 14'' (350mm), 18'' (450mm). Ky çelës është një vegël dore e veçantë për specialistët në fushën e hidraulikës. Prodhuar nga një material mjaft rezistent dhe një dorezë të rehatshme, përdoret për të liruar rakorderitë dhe pjesët e ndryshme në tubacione dhe sifona të ndryshëm.

---

## **56. Çelës hidraulik pinguin**

Çelësi hidraulik (*pinguin*) me madhësi 2", kënd të shtrëngimit 90° dhe gjatësi 60-80cm. Ky çelës përdoret masivisht në punimet hidraulike nga specialistet. Nofullat e çelësit të jenë të trajtuar termikisht dhe të ketë trup çeliku të lyer me pjekje që siguron qëndrueshmeri të lartë mekanike. Materiali çelik me karbon.

## **57. Gërshërë elektrici**

Gërshërë të jetë me gjatësi 140mm-160mm dhe të jetë ideale për prerjen e telave elektrike prej bakri ose alumini me seksione të ndryshme. Doreza gërshërës të jetë e veshur me material cilësor për të krijuar qëndrueshmëri gjatë prerjes. Duhet të realizojë prerje të shpejtë dhe në menyrë efikase.

## **58. Komplet kaçavida VDE**

Seti profesional i kaçavidave VDE të përbëhet minimalisht nga 5 copë kaçavida me maja të imta për vida me madhësi të vogël dhe mesatare me përmasa si vijon: 2 copë të kryq me gjatësi 80mm-100mm, 3 copë të sheshta me gjatësi totale 70mm-140mm. Materiali: Krom-Vanadium kurse bishti të jetë plastik dhe boshti i veshur me gominë speciale për një stabilitet dhe siguri maksimale gjatë punimit.

## **59. Set me dalta druri.**

Daltat të jenë të perbera nga material krom-vanadium me tehe çeliku dhe doreza plastike. Ky set daltash të jetë i përbërë nga minimumi 4 (katër) copë dalta me përmasat 6-8mm x 140-160mm, 10-12mm x 140-160mm, 18-20mm x 140-160mm, 23-25mm x 140-160mm, të përshtatshme për përdorim nga marangozet, zdrukhtaret etj. Të jenë prodhuar nga çeliku me cilësi të lartë për fortësi dhe qëndrueshmëri. Të jenë me tehe preçize për prerje dhe rezistente kundra ndryshkut.

## **60. Darë matëse tensioni dixhital**

Ky aparat matës është një pajisje elektrike me nofulla që hapen për të lejuar shtrëngimin rreth një përcjellësi elektrik. Kjo lejon matjen e rrymës në një përcjellës pa pasur nevojë për të bërë kontakt fizik me të, ose për ta shkëputur atë për futje përmes sondës. Kapëset aktuale zakonisht përdoren për të lexuar madhësinë e rrymës alternative (AC) dhe, me instrumente shtesë, faza dhe forma e valës gjithashtu mund të maten. Kjo pajisje duhet të bëjë të mundur matjen e rrymave minimalisht deri në 1000 A.

### **Të dhënat minimale teknike:**

Ekрани:	LCD me ndriçim
Rryma AC:	60A-1000A
Rryma DC:	60A-600A
Tensioni AC:	600mV-750V
Tensioni DC:	600mV-1000V
Rezistenca:	600Ω-60MΩ
Kapaciteti:	10nf-100mf
Frekuenca:	10Hz-10MHz

## **61. Set profesional punto metali HSS-G**

Punto metali profesionale HSS-G. Seti të përbëhet minimalisht nga 12 punto me përmasa: 2-2.5-3-3.5-4-4.5-5-5.5-6-6.5-7-7.5-8mm. Përdoren për të shpuar në të gjitha llojet e metalit si: hekur,

---

çelik i butë, gizë, bronz etj. Të ndërtuar me çelik special janë shumë të qëndrueshme dhe sigurojnë një shpim të shpejtë dhe preciz. Rezistente nga mbinxehja gjatë shpimit në metalet e forta. Puncto me cilësi dhe jetëgjatësi të lartë.

### **62. Set me punto druri**

Komplet me punto druri profesionale përdoret për të shpuar në të gjitha llojet e drurit dhe materialet e ngjashme me të. Seti të përbëhet minimalisht nga 5 punto me përmasa: 3-4-5-6-8mm. Të jetë i prodhuar me çelik special dhe shumë të qëndrueshme dhe të sigurojë një shpim të shpejtë dhe preciz. Puntot të jenë me cilësi dhe jetëgjatësi të lartë.

### **63. Komplet kriketi 1/2"**

Seti të përbëhet minimalisht nga 18 koka kriketi me përmasa: 10-11-12-13-14-15-16-17-18-19-20-21-22-23-24-27-30-32 mm. Kokat e kriketit me përmasa 1/2" përdoren për vidhosjen e kokës së bullonit ose dados me përmasa të ndryshme. Seti të jetë i pajisur dhe me xhantot dhe aksesoret bazë. Të jenë të përbëra nga materiali krom-vanadium për një qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi përdorimi. Finitura të sigurojë rezistencë ndaj korrozionit dhe të pastrohen lehtë. Paketimi të jetë në kuti plastike ose metalike.

### **64. Ndiriçues LED për vendosje në kokë**

Ndiriçuesi LED të përbëhet nga një dritë e vogël LED e fuqizuar nga bateria e rikarikueshme që qëndron në ballin tuaj, e mbajtur në vend nga një rrip i rregullueshëm. Këta elektrik dore të montuar në kokë ju lirojnë duart për detyra të tjera ndërsa drejtoni një rreze drite të fortë dhe të qëndrueshme para jush. Edhe pse të vegjël, fenerët më të mirë kanë llamba LED të fuqishme të afta për të hedhur rreze drite metra larg. Të jetë i pajisur me një buton standard të ndezjes/fikjes dhe të mundësojë rregullimin e shkëlqimit dhe madhësinë e rrezes.

#### **Të dhënat minimale teknike:**

Jetëgjatësia:	≥ 20.000 orë
Bateri:	4V-12V, 500-900mAh e rikarikueshme
Lloji i lampës:	LED
Ngjyra e Dritës:	≥ 7000K
Fortësia e ndriçimit:	≥ 200 Lm
Koha e punës:	≥ 1 orë dritë e fortë / ≥ 4 orë dritë e dobët
Tensioni për karikim:	Volt 220-240V / 50-60Hz
Fuqia:	≥ 3W

### **65. Disk hekuri i madh për flesibël**

Disku për prerje metali është zgjedhja ideale për prerjen e të gjitha llojeve të metalit. Shtresa të shumëfishta fibër xhami janë endur për të formuar një shtresë jashtëzakonisht të fortë e cila siguron një prerje të shpejtë dhe të pastër.

Diametri i jashtëm:	230 mm
Diametri brendshëm:	22.2 mm
Trashësia:	2-3 mm
Numri i rrotullimeve në minutë:	≥ 6000 rpm
Materiali:	Grimca abrazive

---

### **66. Disk hekuri i vogël për flesibël**

Disku për prerje metali është zgjedhja ideale për prerjen e të gjitha llojeve të metalit. Shtresa të shumëfishta fibër xhami janë endur për të formuar një shtresë jashtëzakonisht të fortë e cila siguron një prerje të shpejtë dhe të pastër.

Diametri i jashtëm: 125 mm

Diametri brendshëm: 22.2 mm

Trashësia: 2-3 mm

Numri i rrotullimeve në minutë:  $\geq 12000$  rpm

Materiali: Grimca abrazive

### **67. Disk diamanti i madh universal për flesibël**

Disk diamanti i madh universal. Përdoret për të prerë të gjitha llojet e materialeve të ndërtimit si: beton, tullë, pllakë, mermer etj. I ndërtuar me material çeliku dhe me dhëmbë diamanti siguron një prerje të shpejtë, të pastër dhe efikase. Disk me cilësi dhe jetëgjatësi të lartë.

Diametri i jashtëm: 230 mm

Diametri brendshëm: 22.2 mm

Trashësia: 2-2.5 mm

Numri i rrotullimeve në minutë:  $\geq 6000$  rpm

### **68. Disk diamanti i vogël universal për flesibël**

Disk diamanti i vogël universal. Përdoret për të prerë të gjitha llojet e materialeve të ndërtimit si: beton, tullë, pllakë, mermer etj. I ndërtuar me material çeliku dhe me dhëmbë diamanti siguron një prerje të shpejtë, të pastër dhe efikase. Disk me cilësi dhe jetëgjatësi të lartë.

Diametri i jashtëm: 125 mm

Diametri brendshëm: 22.2 mm

Trashësia: 2-2.5 mm

Numri i rrotullimeve në minutë:  $\geq 12000$  rpm

### **69. Disk druri i madh për flesibël**

Disk sharre profesional me minimumi 60 dhëmbë. Përdoret për të prerë të gjitha llojet e drurit. Realizon një prerje të shpejtë, të pastër dhe preçize. Trupi i ndërtuar me çelik siguron një qëndrueshmëri të lartë. Dhembët prej vidiumi të japin mundësinë për të mprehur.

Diametri i jashtëm: 235 mm

Diametri brendshëm: 16-25.4mm

Trashësia: 2-2.5 mm

Numri i dhëmbëve:  $\geq 60$

### **70. Disk druri i vogël për flesibël**

Disk sharre profesional me minimumi 40 dhëmbë. Përdoret për të prerë të gjitha llojet e drurit. Realizon një prerje të shpejtë, të pastër dhe preçize. Trupi i ndërtuar me çelik siguron një qëndrueshmëri të lartë. Dhembët prej vidiumi të japin mundësinë për të mprehur.

Diametri i jashtëm: 115 mm

Diametri brendshëm: 16-22.5 mm

Trashësia: 2-2.5 mm

Numri i dhëmbëve:  $\geq 40$

---

### **71. Disk melamini për panel**

Disk sharre melamini profesional për panel marangozi me minimumi 90 dhëmbë. Të realizojë një prerje të shpejtë, të pastër dhe preçize. Trupi të jetë i ndërtuar me çelik i cili siguron një qëndrueshmëri të lartë. Dhëmbët të jenë prej vidiumi dhe të japin mundësinë për t'i mprehur.

Diametri i jashtëm:	300 mm
Diametri brendshëm:	30 mm
Trashësia:	2.5-3.5 mm
Numri i dhëmbëve:	≥ 90

### **72. Disk druri për panel**

Disk sharre druri profesional për panel marangozi me minimumi 35 dhëmbë. Të realizojë një prerje të shpejtë, të pastër dhe preçize. Trupi të jetë i ndërtuar me çelik i cili siguron një qëndrueshmëri të lartë. Dhëmbët të jenë prej vidiumi dhe të japin mundësinë për t'i mprehur.

Diametri i jashtëm:	300 mm
Diametri brendshëm:	30 mm
Trashësia:	2.5-3.5 mm
Numri i dhëmbëve:	≥ 35

### **73. Set punto druri për frezë**

Punto druri (punto për frezë). Ky set puntosh frezë të jetë i përbërë nga minimumi 3 (tre) copë punto me përmasat Ø25mm, Ø32mm, Ø35mm. Përdoren për të bërë punë dekorative në të gjitha llojet e drurit. Të jetë e ndërtuar me çelik special dhe të jetë shumë e qëndrueshme duke siguruar një prerje të shpejtë dhe preçize. Të jetë punto me cilësi dhe jetëgjatësi të lartë.

### **74. Letër zmerile për rashinator parketi**

Vendoset në pajisjen e rashinatorit të parketit dhe ka formë cilindrike. Ka disa ashpërsi, P40, P60, P80, P100, P120, P150. Sasia e kërkuar do të ndahet sipas ashpërsisë së letrës zmerile dhe do të vihet në dispozicion nga kontraktuesi sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Përmasat e fletës cilindrike H,200mm x L 750 mm.

### **75. Shkallë portative të palosshme alumini**

Shkalla të jetë ndërtuar për përdorim profesional dhe të përbëhet nga dy pjesë të palosshme e shkallëzuar nga të dyja anët, të përdoret nga bojaxhijtë, ndërtuesit etj. për lysterje, punime të gipsit, vendosje e letrës së murit etj. Të jetë e përbërë nga material alumini, shumë rezistente dhe e lehtë për t'u transportuar. Peshëmbajtja jo më pak se 150 kg. Lartësia maksimale e punës të jetë jo më pak se 400cm. Të plotësojë Standartin Shqiptar SSH EN 131-2:2010+A2:2017 ose ekuivalentin e tij.

### **76. Kavo me kriket**

Litari (shirit) me mekanizëm çikrik për bagazhe, 5 m x 5 cm është ideal për sigurimin e ngarkesave me forcë shtrëngimi 100 kg. Litari është rezistent ndaj kushteve atmosferike. Litari të jetë material cilësor dhe rezistent ndaj ujit, vajrave dhe agentëve të tjerë atmosferikë.



---

**77. Furçë për pastrim kaldaje**

Furça të jetë me fije çeliku dhe rezistente për pastrimin e sipërfaqeve të forta, të jetë me dorezë plastike.

**78. Furçë- fshesë me bisht për pastrim tarrace**

Të jetë me fije çeliku dhe të bëjë të mundur heqjen mbeturinave të bojës, çimentos dhe materialeve të ndryshme.

**79. Susta për zhblokim tubacionesh Ø 8-10, gjatësi 20-30 m**

Të jetë material cilësor dhe me përmasa sipas kërkesave të AK.

**80. Litar ngarkese**

Rripat e ngarkesës të jenë me gjatësi 4-6 metra dhe aftësi mbajtëse deri në 3 ton. Ato përdoren gjerësisht për ngritjen e paletave si dhe të ngarkesave të tjera gjatë transportimit të tyre. Prodhuar nga një material shumë rezistent si dhe të pajisura me unaza në fundet e tyre për të bërë të mundur kapjen e tyre lehtësisht.

Materiali: PP/poliester ose ekuivalent.

**81. Lopatë në formë luge për pastrimin e pusetave**

- Të jetë material çelik cilësor.
- Të jetë e pajisur me bisht cilindrik, jo më pak se 2.5m të gjatë.

**Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:**

Mallrat objekt prokurimi duhet të jenë të reja dhe duhet të jenë ruajtur në kushte magazinimi të cilat nuk kanë sjellë ndryshimin e cilësisë si korrozioni, dëmtimet nga goditjet etj. Kontraktori është i detyruar që me automjetet e veta dhe me punonjësit e tij të realizojë dërgimin e mallit në destinacionin e parashikuar në DST brenda kushteve teknike dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në kohë dhe sasi sipas afateve të parashikuara në kontratë.

## Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

#### Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Përshkrimi i mallrave	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi pa tvsh	Vlera gjithsej
1	Zgjatues elektrik ballandez	copë	5	-	-
2	Çekiç mekaniku	copë	8	-	-
3	Çelës anglez i madh	copë	7	-	-
4	Set çelësa tub	set	1	-	-
5	Daltë matrapiku me majë me shlica	copë	10	-	-
6	Daltë matrapiku petashuqe me shlica	copë	8	-	-
7	Daltë me majë	copë	16	-	-
8	Daltë petashuqe	copë	16	-	-
9	Elmas xhami (profesional)	copë	13	-	-
10	Fletë sharre për sega	copë	21	-	-
11	Govatë Ilaçi	copë	5	-	-
12	Indikator rryme (profesional)	copë	17	-	-
13	Pistoletë gazi (torçë) për katrama	copë	3	-	-
14	Mallo metalike me dhëmbë	copë	7	-	-
15	Mallë plastike	copë	14	-	-
16	Mallë metalike	copë	17	-	-
17	Mastar alumini	copë	17	-	-
18	Metër metalik	copë	17	-	-
19	Metër shirit	copë	2	-	-
20	Mistri	copë	21	-	-
21	Nivelues me magnet	copë	4	-	-
22	Përdaf muratori	copë	14	-	-
23	Preçinator (profesional)	copë	2	-	-

24	Prerës tubash plastike	copë	<b>6</b>	-	-
25	Zorrë uji plastike	ml	<b>100</b>	-	-
26	Mbështjellës për zorrë uji plastike	copë	<b>4</b>	-	-
27	Mbështjellës për zorrë uji plastike pajisur me rakorderi	copë	<b>4</b>	-	-
28	Metër largësie me lazer	copë	<b>2</b>	-	-
29	Set puntosh betoni	set	<b>19</b>	-	-
30	Set puntosh druri	set	<b>10</b>	-	-
31	Set bazik punto metali HSS	set	<b>285</b>	-	-
32	Set puntosh betoni SDS-PLUS	set	<b>2</b>	-	-
33	Sharrë dore druri	copë	<b>2</b>	-	-
34	Sharrë dore hekuri me lama të ndërrueshme	copë	<b>2</b>	-	-
35	Lama për sharrë dore hekuri	copë	<b>10</b>	-	-
36	Sqepar	copë	<b>8</b>	-	-
37	Kazma pa bisht	copë	<b>8</b>	-	-
38	Bisht për kazma	copë	<b>15</b>	-	-
39	Karroçë dore	copë	<b>6</b>	-	-
40	Rrota për karroçë dore	copë	<b>6</b>	-	-
41	Lopatë pa bisht	copë	<b>15</b>	-	-
42	Bisht lopate	copë	<b>20</b>	-	-
43	Thika me lamë	copë	<b>12</b>	-	-
44	Set lame	set	<b>7</b>	-	-
45	Sharrë dore për gips	copë	<b>3</b>	-	-
46	Set çelësash hegzagon	set	<b>2</b>	-	-
47	Set kaçavidash	set	<b>11</b>	-	-
48	Pinca universale	copë	<b>20</b>	-	-
49	Pinca VDE	copë	<b>17</b>	-	-
50	Tronkëza (pincë prerëse diagonale )	copë	<b>7</b>	-	-
51	Havi kallaji	copë	<b>2</b>	-	-
52	Kabëll starteri me kapëse	copë	<b>2</b>	-	-
53	Kaçavidë mekanike me majë kryq	copë	<b>8</b>	-	-
54	Kaçavidë mekanike me majë petë	copë	<b>8</b>	-	-
55	Set çelësa hidraulik papagall	set	<b>5</b>	-	-
56	Çelës hidraulik pinguin	copë	<b>4</b>	-	-
57	Gërshërë elektrikë	copë	<b>5</b>	-	-

58	Set kaçavida elektrike VDE	set	5	-	-
59	Set me dalta druri	set	4	-	-
60	Darë matëse tensioni dixhitale	copë	8	-	-
61	Set profesional punto metali HSS-G	set	3	-	-
62	Set punto druri	set	4	-	-
63	Set kriketi	set	2	-	-
64	Ndriçues led për vendosje në kokë	copë	5	-	-
65	Disk hekuri i madh për flesibël	copë	200	-	-
66	Disk hekuri i vogël për flesibël	copë	150	-	-
67	Disk diamanti i madh universal për flesibël	copë	10	-	-
68	Disk diamanti i vogël universal për flesibël	copë	10	-	-
69	Disk druri i madh për flesibël	copë	10	-	-
70	Disk druri i vogël për flesibël	copë	20	-	-
71	Disk sharrë melamini për panel	copë	10	-	-
72	Disk sharrë druri për panel	copë	10	-	-
73	Set punto druri për frezë	set	4	-	-
74	Letër zmerile për rashinator parketi	copë	60	-	-
75	Shkallë portative të palosshme alumini	copë	4	-	-
76	Kavo me kriket	copë	6	-	-
77	Furçë për pastrim kaldaje	copë	4	-	-
78	Furçë-fshesë me bisht me fiye metalike	copë	10	-	-
79	Susta për zhbllokim tubacionesh	copë	3	-	-
80	Litar ngarkese	copë	4	-	-
81	Lopatë në formë luge për pastrim të pusetave	copë	2	-	-
	<b>Vlera totale pa tvsh</b>				-
	<b>TVSH 20%</b>				-
	<b>Vlera totale me tvsh</b>				-

**Afatet e lëvrimit:**

Artikulli Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Zgjatues elektrik ballandez	copë	5	DPOP	10 ditë
2	Çekiç mekaniku	copë	8	DPOP	10 ditë

3	Çelës anglez i madh	copë	7	DPOP	10 ditë
4	Set çelësa tub	set	1	DPOP	10 ditë
5	Daltë matrapiku me majë me shlica	copë	10	DPOP	10 ditë
6	Daltë matrapiku petashuqe me shlica	copë	8	DPOP	10 ditë
7	Daltë me majë	copë	16	DPOP	10 ditë
8	Daltë petashuqe	copë	16	DPOP	10 ditë
9	Elmas xhami (profesional)	copë	13	DPOP	10 ditë
10	Fletë sharre për sega	copë	21	DPOP	10 ditë
11	Govatë llaçi	copë	5	DPOP	10 ditë
12	Indikator rryme (profesional)	copë	17	DPOP	10 ditë
13	Pistoletë gazi (torçë) për katrama	copë	3	DPOP	10 ditë
14	Mallo metalike me dhëmbë	copë	7	DPOP	10 ditë
15	Mallë plastike	copë	14	DPOP	10 ditë
16	Mallë metalike	copë	17	DPOP	10 ditë
17	Mastar alumini	copë	17	DPOP	10 ditë
18	Metër metalik	copë	17	DPOP	10 ditë
19	Metër shirit	copë	2	DPOP	10 ditë
20	Mistri	copë	21	DPOP	10 ditë
21	Nivelues me magnet	copë	4	DPOP	10 ditë
22	Përdaf muratori	copë	14	DPOP	10 ditë
23	Preçinator (profesional)	copë	2	DPOP	10 ditë
24	Prerës tubash plastike	copë	6	DPOP	10 ditë
25	Zorrë uji plastike	ml	100	DPOP	10 ditë
26	Mbështjellës për zorrë uji plastike	copë	4	DPOP	10 ditë
27	Mbështjellës për zorrë uji plastike pajisur me rakorderi	copë	4	DPOP	10 ditë
28	Metër largësie me lazer	copë	2	DPOP	10 ditë
29	Set puntosh betoni	set	19	DPOP	10 ditë
30	Set puntosh druri	set	10	DPOP	10 ditë
31	Set punto çeliku	set	285	DPOP	10 ditë
32	Set puntosh betoni SDS-PLUS	set	2	DPOP	10 ditë
33	Sharrë dore druri	copë	2	DPOP	10 ditë
34	Sharrë dore hekuri me lama të ndërrueshme	copë	2	DPOP	10 ditë
35	Lama për sharrë dore hekuri	copë	10	DPOP	10 ditë
36	Sqepar	copë	8	DPOP	10 ditë
37	Kazma pa bisht	copë	8	DPOP	10 ditë
38	Bisht për kazma	copë	15	DPOP	10 ditë
39	Karroccë dore	copë	6	DPOP	10 ditë
40	Rrota për karrocë dore	copë	6	DPOP	10 ditë

41	Lopatë pa bisht	copë	<b>15</b>	DPOP	10 ditë
42	Bisht lopate	copë	<b>20</b>	DPOP	10 ditë
43	Thika me lamë	copë	<b>12</b>	DPOP	10 ditë
44	Set lame	set	<b>7</b>	DPOP	10 ditë
45	Sharrë dore për gips	copë	<b>3</b>	DPOP	10 ditë
46	Set çelësash hegzagon	set	<b>2</b>	DPOP	10 ditë
47	Set kaçavidash	set	<b>11</b>	DPOP	10 ditë
48	Pinca universale	copë	<b>20</b>	DPOP	10 ditë
49	Pinca VDE	copë	<b>17</b>	DPOP	10 ditë
50	Tronkëza (pincë prerëse diagonale )	copë	<b>7</b>	DPOP	10 ditë
51	Havi kallaji	copë	<b>2</b>	DPOP	10 ditë
52	Kabëll starteri me kapëse	copë	<b>2</b>	DPOP	10 ditë
53	Kaçavidë mekanike me majë kryq	copë	<b>8</b>	DPOP	10 ditë
54	Kaçavidë mekanike me majë petë	copë	<b>8</b>	DPOP	10 ditë
55	Set çelësa hidraulik papagall	set	<b>5</b>	DPOP	10 ditë
56	Çelës hidraulik pinguin	copë	<b>4</b>	DPOP	10 ditë
57	Gërshërë elektrici	copë	<b>5</b>	DPOP	10 ditë
58	Set kaçavida elektrike VDE	set	<b>5</b>	DPOP	10 ditë
59	Set me dalta druri	set	<b>4</b>	DPOP	10 ditë
60	Darë matëse tensioni dixhitale	copë	<b>8</b>	DPOP	10 ditë
61	Set punto metali HSS	set	<b>3</b>	DPOP	10 ditë
62	Set punto druri	set	<b>4</b>	DPOP	10 ditë
63	Set kriketi	set	<b>2</b>	DPOP	10 ditë
64	Ndriçues led për vendosje në kokë	copë	<b>5</b>	DPOP	10 ditë
65	Disk hekuri i madh për flesibël	copë	<b>200</b>	DPOP	10 ditë
66	Disk hekuri i vogël për flesibël	copë	<b>150</b>	DPOP	10 ditë
67	Disk diamanti i madh universal për flesibël	copë	<b>10</b>	DPOP	10 ditë
68	Disk diamanti i vogël universal për flesibël	copë	<b>10</b>	DPOP	10 ditë
69	Disk druri i madh për flesibël	copë	<b>10</b>	DPOP	10 ditë
70	Disk druri i vogël për flesibël	copë	<b>20</b>	DPOP	10 ditë
71	Disk sharrë melamini për panel	copë	<b>10</b>	DPOP	10 ditë
72	Disk sharrë druri për panel	copë	<b>10</b>	DPOP	10 ditë
73	Set punto druri për frezë	set	<b>4</b>	DPOP	10 ditë
74	Letër zmerile për rashinator parketi	copë	<b>60</b>	DPOP	10 ditë
75	Shkallë portative të palosshme alumini	copë	<b>4</b>	DPOP	10 ditë
76	Kavo me kriket	copë	<b>6</b>	DPOP	10 ditë
77	Furçë për pastrim kaldaje	copë	<b>4</b>	DPOP	10 ditë

78	Furçë-fshesë me bisht me fije metalike	copë	<b>10</b>	DPOP	10 ditë
79	Susta për zhbllokim tubacionesh	copë	<b>3</b>	DPOP	10 ditë
80	Litar ngarkese	copë	<b>4</b>	DPOP	10 ditë
81	Lopatë në formë luge për pastrim të pushtave	copë	<b>2</b>	DPOP	10 ditë

Shpjegim i termave: **DPOP** → Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë

## Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

---

i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Fusha e veprimtarisë së operatorit ekonomik ofertues duhet të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.



---

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

